



SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
KOSOVË

FTESË PËR OFERTË

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar. SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është e interesuar që gjatë muajit Korrik ose Gusht të ju sigurojë fëmijëve pushimin veror.

Me këtë rast ju bejmë ftesë për ofertë në përputhje me specifikacionin si më poshtë për:

Akomodim për Pushime verore për fëmijë– pansion i plotë në bregdetin shqiptarë (Velipojë, Shëngjin, Golem, Durrës, Mali Robit, Shkëmbi Kavajës ose Vlorë)

Akomodimi duhet të bëhet për gjithsejt 56 persona njekohësisht për 10 netë brenda periudhës 24 Korrik – 30 Gusht 2021

Për akomodim të fëmijëve së bashku me stafin përcjellës nevojiten:

- 11 dhoma me nga 3 shtretër= 33 shtretër
- 5 dhoma me nga 4 shtretër= 20 shtretër
- 1 dhoma me 2 shtretër= 2 shtretër
- 1 dhoma me 1 shtrat= 1 shtrat
- Të gjitha dhomat të kenë kondicioner
- Hoteli të jetë afër plazhit
- Pansion i plotë (mëngjesi, dreka dhe darka)
- Hoteli të ketë pishinë dhe këndin e lojërave për fëmijë (e preferuar)
- Në çmim të ofertës duhet të përfshihen edhe qadrat me shezlonge
- Qasje të lehtë nga hoteli në plazh si dhe në pishinën e hotelit dhe në hapësirat tjera që ofron hoteli si kënde lojërash etj.

Në pajtueshmëri me Udhëzimet nga institucionet shëndetësore për luftimin e COVID-19, Hoteli duhet t'i respektojë të gjitha masat kundër COVID-19, duke dezinfektuar dhomat, dhe të gjitha hapësirat tjera të hotelit

Ofertuesit së bashku me ofertën duhet të dërgojnë:

- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit/ NUI
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur apo me llogo zyrtare
- Në ofertë duhet të ceken cmimet në euro pa tvsh (për person)

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë 40 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë

Kriteret e përzgjedhjes:

1. Hoteli i cili ka në afërsi plazhin
2. Dhomat e hotelit të kondicionuara
3. Përparësi do të ketë hoteli i cili posedon pishinë dhe këndin e lojrave për fëmijë.
4. Pas plotësimit të kriterëve të lartëcekura, cmimi më i lirë

Shënim: Në rast të ndryshimit të situatës epidemiologjike me virusin COVID-19, dhe udhëzimeve nga institucionet shëndetësore për mbyllje; ndalesë të qarkullimit, organizata SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë nuk merr përgjegjësi për anulimin e akomodimit ose kompenzimin e çfarëdolloji.

Ofertat duhet të dërgohen në email adresën: procurement1@soskosova.org deri me datën: 20.07.2021, Ofertat e dorëzuara me vonesë nuk do të shqyrtohen.

Për ndonjë paqartësi mund të kontaktoni në e-mail adresën: procurement1@soskosova.org.

A loving home for every child